



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETËEVALUIMIN E FAKULTETIT TË ADMINISTRIMIT TË BIZNESIT - KUMANOVË

Kumanovë, 2024

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i evaluimit	3
2. Përshkrimi i fakultetit	3
2.1. Historiku.....	3
2.2. Plan i strategjik.....	4
3. Struktura e fakultetit.....	5
3.1. Organogrami.....	5
4. Veprimtaria mësimore	6
4.1. Struktura e kuadrit mësimor	6
5. Struktura e studentëve.....	7
5.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	7
5.2. Struktura e Studentëve në Ciklin e II - dytë (Master)	8
6. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte.....	9
7. Realizim i orës mësimore në programet studimore të FAB.....	11
7.1. Anketimi i studentëve.....	11
8. Hapësirat dhe resurset materiale	12
8.1. Hapësirat.....	12
9. Swot analiza dhe Konkluzioni	14

1. QËLLIMI I EVALUIMIT

Procesi i evaluimit të brendshëm qëllim kryesor ka rritjen e cilësisë, të jemi konkurrues në treg dhe t'u ofrohen studentëve programe në përputhje me universitetet tjera në rajon dhe më gjerë. Po ashtu nëpërmjet evaluimit individual të pedagogëve tenton të detektojë mangësitë dhe përparësitë në procesin mësimor me qëllim që po të njëjtat të përmirësohen ose të zhvillohen. Raporti i vetevaluimit për Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë trajton këto pjesë:

- a. Përshkrimi i Fakultetit (historiku)
- b. Struktura e Fakultetit
- c. Veprimtaria mësimore
- d. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor
- e. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike
- f. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte
- g. Rezultatet e evaluimit të orës mësimore
- h. SWOT analiza dhe konkluzioni

2. PËRSHKRIM I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Universiteti i Tetovës ka shënuar të arritura të mëdha në të gjitha drejtimet. Ai është ngritur tashmë në një institucion arsimor dhe shkencor me përmasa kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, duke tërhequr kah vetja profesoratin më të mirë të vendit dhe rajonit, figurat më eminente të arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi me një infrastrukturë dhe nivel të lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe me avantazhe në raport me konkurrencën.

Fakulteti i Administrimit të Biznesit në Kumanovë, si pjesë e Universitetit të Tetovës, u themelua më datë 22 nëntor 2008, si iniciativë e intelektualëve shqiptarë, të shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike, si dhe të gjithë dashamirësve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Sot, avantazhet tona qëndrojnë në infrastrukturën që e përbëjnë sallat, labororet, amfiteatret, programet studimore bashkëkohore, në funksion të kërkesave të tregut dhe stafin akademik të kualifikuar që përdorin literaturën më bashkëkohore.

Fakulteti Administrimit të Biznesit në Kumanovë aktualisht është i organizuar në dy programe studimore:

CIKLI i I - parë

1. Administrim Biznesi (240 ECTS)
2. Administratë Publike (240 ECTS)

Cikli i II - dytë (Master)

1. Administrim Biznesi (60 ECTS)
2. Administratë Publike (60 ECTS)

Këto programe studimore janë të organizuara sipas standardeve më bashkëkohore, Procesit të Bolonjës dhe Sistemit European të Transferit të Kredive (ECTS), të organizuara me akreditimin 4+1.

2.2. Plani strategjik

Programi studimor Administrim Biznesi ofron një lidhje ndërmjet teorisë dhe praktikës, si një nga kushtet më të rëndësishme për përvetësimin e shkathtësive dhe njohurive të nevojshme për karrierë të suksesshme.

Programi studimor Administratë Publike përgatit udhëheqës të ardhshëm, kryesisht për institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal, si dhe në shoqërinë civile.

Qëllimet e Fakultetit të Administrimit të Biznesit, përmes programeve studimore janë:

- Përgatitja e studentëve për ndërtim karriere në sektorin publik, joqeveritar dhe privat.
- Zhvillimi i kompetencave dhe menaxhimi me institucionet publike, hulumtuese, analizimi i politikave publike, menaxhimi me resurset njerëzore dhe me organizatat jofitimprurëse.

Plani strategjik paraqet një strukturë, ku ngërthehen një sërë aktiviteteve që do të merren në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë, në planin afatmesëm dhe afatgjatë, në përputhshmëri me perspektivat vizionare dhe misionin që duhet realizuar për të arritur qëllimet e institucionit tonë. Në pika më të shkurtra paraqesim këtë strukturë aktiviteteve si më poshtë:

- realizim të programeve studimore konform Ligjit për Arsim të Lartë dhe kërkesave të tregut bazuar në bashkëpunim edhe me komunitetin e bizneseve;

- përkujdesje maksimale në avansimin e stafit akademik me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kyçjes së tyre në hulumtime shkencore, nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe publikimeve të punimeve cilësore në revista prestigjioze të ranguar në rrafshin ndërkombëtar;
- është paraparë që të jemi pjesë e komunikimit, të detektimit dhe ofrimit të zgjidhjeve rreth problematikave ekonomike që do të paraqiten në periudhën vijuese. Këto aktivitete mendohet të realizohen përmes seminareve, debateve shkencore dhe profesionale, konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- stimulimi nëpërmjet motivimit, si dhe kultivimi i arritjeve akademike, mësimore dhe shkencore të stafit dhe studentëve;
- rritjen e normës së informimit të studentëve, stafit akademik dhe administrativ, përmes implementimit të ERP sistemeve, forcimin e bashkëpunimit me studentët dhe bizneset përmes Qendrës për Karrierë dhe rritjen e mundësive për kyçjen e studentëve në tregun e punës;
- evaluimi i vazhdueshëm i procesit mësimor, realizimi i kurikulave dhe qëllimeve të programit studimor;
- mbështetja e studentëve me sukses të dalluar për mobilitet konform rregullave që parasheh sistemi i Bolonjës i aplikuar në procesin mësimor tek institucioni jonë dhe mundësi për punësim të tyre.

3. STRUKTURA E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Fakulteti i Administrimit të Biznesit në Kumanovë veprimtarinë e tij e bazon në Ligjin për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Prandaj në kuadër të tij ekzistojnë organet përkatëse të parapara me Ligjin për arsim të lartë siç janë:

Këshilli Mësimor-Shkencor, i cili përbëhet nga profesorë të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore dhe përfaqësuesit e studentëve;

- Dekani;
- Prodekanët;

- Sekretari;
- Shefat e programeve studimore;
- Administrata dhe
- Shërbimi teknik.

Me Këshillin Mësimor-Shkencor të Fakultetit për Administrim të Biznesit udhëheq dekan, ndërsa të gjitha vendimet në fakultet i merr Këshilli Mësimor-Shkencor me shumicë votash, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjen me votim të fshehtë të dekanit dhe prodekanëve, komisionit të evaluimit, etj. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Këshillin Mësimor-Shkencor, të cilët zgjidhen nga Kuvendi Studentor i Fakultetit.

Organogrami i Fakultetit të Administrimit të Biznesit

Këshilli Mësimor-Shkencor	
Dekani	
Prodekani për arsim	Prodekani për shkencë
Sekretari	
Mësimdhënësit	Studentët
Administrata	Shërbimi teknik

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

4.1. Struktura e kuadrit mësimor

Në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë, procesin mësimor në vitin akademik 2020/21 e kanë realizuar gjithsej 4 mësimdhënës me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme 20. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit në Fakultetin e Administrimit të Biznesit në Kumanovë realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës.

Tabela 1. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademik dhe gjinisë në Fakultetin e

Administrimit të Biznesit- Kumanovë.

NR.	THIRJA	Statusi i punës		Gjinia	
		Rregullt	Part - time	M	F
1.	ORDINAR	2	/	2	/
2.	INORDINAR	1	/	1	/
3.	DOCENT	1	7	8	/
4.	ASISTENT	/	12	8	4
5.	DEMONSTRATOR	/	1	1	/

5. STRUKTURA E STUDENTËVE

5.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2020/2021, në drejtimin Administrim Biznesi ishin 20 studentë me status të rregullt, kurse 24 me korrespondencë. Prej të cilëve, femra ishin 13, ndërsa meshkuj 31.

Tabela 2. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Administrim Biznesi

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korrespondencë	Nr i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2020-2021	31	13	20	24	44	3
2021-2022	35	14	21	32	53	10

Bazuar në regjistrimin e studentëve sipas kategorive të caktuara në vitin akademik 2020/2021, në drejtimin Administratë Publike ishin 32 studentë me status të rregullt, kurse 8 me korrespondencë. Prej të cilëve, femra ishin 16, ndërsa meshkuj 24.

Tabela 3. Struktura e studentëve sipas statusit dhe gjinisë në programin studimor Administratë Publike

Viti akademik	M	F	Të rregullt	Korespodencë	Nr. i studentëve të regjistruar	Të diplomuar
2020-2021	24	16	32	8	40	5

2021-2022	15	23	23	15	38	3
-----------	----	----	----	----	----	---

5.2. Struktura e studentëve në Ciklin e dytë të studimeve (Master)

Në vitin akademik 2020/21, në studimet e Ciklit të dytë Master janë regjistruar gjithsej 3 studentë vendas dhe 1 student shtetas i huaj prej të cilëve në drejtimin Administrim Biznesi (3+2) dhe 4 studentë në drejtimin Administrim Biznesi (4+1).

Tabela 4. Numri i studentëve në Ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2020-21

Nr. Rendor	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	ADMINISTRIM BIZNESI	3	/	7
2	3+2	ADMINISTRATË PUBLIKE	/	/	/
3	4+1	ADMINISTRIM BIZNESI	4	1	1
			7	1	7

Në vitin akademik 2021/22, në studimet e Ciklit të dytë Master janë regjistruar gjithsej 4 studentë në drejtimin Administratë Publike (4+1).

Tabela 5. Numri i studentëve në Ciklin e dytë sipas programeve studimore në vitin akademik 2021-22

Nr. Rendor	Programi studimor	Drejtimi	Të rregullt	Shtetas të huaj	Gjithsej
1	3+2	ADMINISTRIM BIZNESI	/	/	/
2	4+1	ADMINISTRATË PUBLIKE	4	/	4
3	4+1	ADMINISTRIM BIZNESI	/	/	/
			4	1	4

6. VEPRIMTARIA SHKECORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE


Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve hulumtuese, Fakulteti i Administrimit të Biznesit, së bashku me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës, organizon Konferenca Shkencore me bord editorial nga pedagogë vendas dhe pedagogë me të cilët Universiteti ynë ka bashkëpunim të ndërsjelltë, dhe boton revistën shkencore “Economic Vision” me bord nga pedagogë vendas dhe të huaj. Vijueshmëria aktive si pjesëmarrës dhe organizatorë të konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta e stafit ka rezultuar me prezente të suksesshme të arritjeve shkencore dhe me bashkëpunime të ardhshme në hulumtime shkencore mes pedagogëve të universitetit tonë dhe universiteteve tjera. Po ashtu, organizimet e konferencave kanë mundësuar shkëmbim të stafit të Fakultetit të Administrimit të Biznesit dhe fakulteteve tjera, sidomos për ciklet e studimit të nivelit të parë dhe të dytë.

Më 15-16. XI.2021, Fakulteti i Administrimit të Biznesit së bashku me Fakultetin Ekonomik organizuan Konferencën e 7-të Shkencore; më 17-18.XI.2022, Fakulteti i Administrimit të Biznesit së bashku me Fakultetin Ekonomik, organizuan Konferencën e 8-të Shkencore; më 15-17.XI.2023, Fakulteti i Administrimi të Biznesit së bashku me Fakultetin Ekonomik, organizuan Konferencën e 9-të shkencore. Në të gjitha konferencat e lartpërmendura, referuan një numër i madh profesorësh, studiuesish nga vendi, rajoni dhe më gjerë.

Tabela 6. Revistat shkencore të publikuara nga Fakulteti i Administrimit të Biznesit gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022 (ISSN: 1857-9566, Print; ISSN: 2545-4544 (Online))

TITULLI I REVISTES	VOLUMI, VITI
ECONOMIC VISION <i>International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism</i>	(Vol.8.No.15-16) 2021
ECONOMIC VISION <i>International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism</i>	(Vol.9.No17-18) 2022

Në revistën shkencore “Economic Vision” të Fakultetit të Administrimit të Biznesit dhe Fakultetit Ekonomik, në vitin 2021 u botua volumi i VIII dhe numri 15-16, ku u botuan 21 punime shkencore; në vitin 2022, volumi i IX dhe numri 17-18, u botuan 19 punime shkencore.



Grafiku 1. Punimet e botuara në revistën shkencore “Economic Vision” sipas autorëve

Në botimin e vitit 2021 të revistës shkencore “Economic Vision”, punimet e veta i botuan pesëmbëdhjetë autorë vendas dhe gjashtë autorë të huaj; në botimin e vitit 2022, punimet e veta i botuan gjashtëmbëdhjetë autorë vendas dhe tre autorë të huaj.

Në vitet akademike 2019/20, 2020/21 dhe 2021/2022 stafi akademik i Fakultetit të Administrimit të Biznesit ka botuar rreth tridhjetë e pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

7. REALIZIM I ORËS MËSIMORE NË PROGRAMET STUDIMORE TË FAKULTETIT TË ADMINISTRIMIT TË BIZNESIT

7.1. Anketimi i studentëve

Gjatë vitit 2021 në programet studimore të Fakultetit të Administrimit të Biznesit është realizuar evaluimi i orëve mësimore ku gjithsej janë plotësuar nga studentët 120 pyetësorë. Rreth 92 % e përgjigjeve në fakultetin e Administrimit të Biznesit tregojnë se ligjëratat fillojnë saktë sipas orarit, kurse rreth 85 % se ligjëratat mbarojnë në kohën e paraparë sipas orarit të shpallur. Përqindja më e madhe e studentëve që deklarojnë se ligjëratat fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit të paraparë janë në programin studimor Administrim Biznesi dhe në Administratë Publike.

Rreth 76% e studentëve në Fakultetin e Administrimit të Biznesit deklarojnë se gjatë ligjëratës kanë bërë pauzë 10 deri 15 minuta.

Për realizim të orëve gjatë ligjëratave në Fakultetin e Administrimit të Biznesit përdoren mjete të ndryshme për prezantim. Studentët deklarojnë rreth (50%) se gjatë ligjëratës mësimdhënësit kanë përdorur Power Point prezantime, kurse rreth 30% e studentëve deklarojnë se përdoret tekst në dërasë dhe diku rreth (10%) deklarojnë se gjatë ligjëritimit mësimdhënësit nuk përdorin asnjë mjet për të realizuar ligjëratën. Përqindja më e madhe e studentëve të cilët deklarojnë se mësimdhënësit përdorin power-point për prezantim me përqindje më të madhe diku (55%) janë studentët e programit studimor Administrim Biznesi dhe rreth (45%) janë studentët e programit studimor Administratë Publike.

Realizim i ligjëratave

Studentët kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndë të caktuara nëpërmjet shtatë pyetjeve. Në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e orës më të gjitha pyetjet. Edhe atë vlerësim më pozitiv kanë dhënë për sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjëritimit. Që të tre karakteristikat e mësimdhënësve janë vlerësuar si dominante pozitive në të gjitha programet studimore të Fakultetit të Administrimit të Biznesit (tabela1).

Tabela 7. Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

	Tema përputhshmëri me ligjëratat	Ligjërata të qarta	Ligjërues i sigurt	Ligjërues bindës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
<i>Administrim Biznesi</i>	4.12 (70)	4.31 (70)	4.43 (70)	4.31 (70)
<i>Administratë Publike</i>	3.84 (50)	4.36 (50)	4.57 (50)	4.46 (50)

Përmbajtja e ligjërimit/prezantimit është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve në të cilët janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem(1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët kanë deklaruar se materiali i prezantuar gjatë ligjërimit ka qenë në përputhshmëri me temën e prezantuar në fillim të orës (M=4.12 dhe M=3.84), mësimdhënësit pyesin për paqartësi (M=4.31 dhe M=4.36) në indikatorin ligjerues i sigurt me temën përgjigjet janë (M=4.42 dhe M=4.57), ndërsa në përgjigjen për ligjërues bindës (M=4.31 dhe M=4.46) dhe se studentët e kanë pasur të qartë në çka duhet të fokusohen për të përgatitur temën në temën konkrete (M=4.43), ndërsa vlerësimi nën mesatar është për indikatorin “orientim i mjaftueshëm për burime shtesë” (M=2.75%), si dhe “lidhshmëria e përmbatjeve të prezantuar me përmbajtje të lëndëve tjera” (M=2.64%).

8. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

8.1. Hapësirat


Вид на објектот Lloji i objektit	Единици Njësitë	Површина во m ² Sipërfaqja m ²
Амфитеатар/Amfiteatër	7	700 m ²
Предавални/Salla	12	747 m ²
Канцелари/Zyra	18	262 m ²
Административен простор Hapësirë administrative	8	257 m ²
Компјутерска училиница Klasa kompjuterike	1	85 m ²
Вкупно Gjithsej	46	2 051 m²

8.2. Resurset materiale

Два Cisco 16 Port 10/100 Switch
Еден ADSL Router / 4 port switch
1 x Wireless router / 4 port switch
7 x Switch 10/100
1x patch panel
1x Rack
1x modem telelabs 512
5 x Laptop
30 x PC Desktop
5 x Печатачи
1 x Smart Board
6 x Проектори
1 x Fax
1x Finger уред за пријавување вработени

5 x License
Win XP pro Laptop

9. SWOT ANALIZA DHE KONKLUZIONI



SWOT analiza e Fakultetit të Administrimit të Biznesit nxjerr në sipërfaqe fuqitë ku përfshihen:

- statistika të besueshme në dispozicion;
- procedura të qarta të regjistrimit të semestrave;
- zhvillim i vazhdueshëm i strukturave të fakultetit;
- ndryshime të programeve studimore në përputhje me ndryshimet në trendet botërore;
- infrastrukturë të përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese;
- programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative;
- sigurinë, bindëshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjërimit;
- avansimi i vazhdueshëm i stafit akademik.

Realizimi i procesit të evaluimit të Fakultetit të Administrimit të Biznesit paraqet një çështje mjaftë me peshë, e cila përfshinë dy segmente kryesore: zbatimin e dispozitave të Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat obligojnë në realizimin e të njëjtit dhe njohja me gjendjen reale në të cilën zhvillohet procesi mësimor shkencor.

Sigurisht, të dhënat përkatëse do të jenë udhërrëfyese për veprimtarinë tonë në vazhdimësi, për përcaktimin e politikave zhvillimore të Fakultetit të Administrimit të Biznesit, që në këtë mënyrë mund të arrihen rezultate konkrete në sferën mësimore-shkencore dhe hapat konkretë, të cilët duhet të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përsosjes së veprimtarisë administrative në fakultet.

Gjatë përgatitjes së raportit, kemi hasur në bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme nga menaxhmenti, pedagogët dhe administrata e Fakultetit të Administrimit të Biznesit, që flet për një klimë kooperuese dhe nivel komunikimi akademik të të gjitha hallkave në kuadër të Fakultetit të Administrimit të Biznesit.